

VENDIM
Nr. 456, datë 26.7.2023

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE BUXHETORE
TË MINISTRISË SË FINANCave DHE EKONOMISË, NË BUXHETIN E
MIRATUAR PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve buxhetore, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor “Planifikim, menaxhim, administrim”, në artikullin 602, shtohet fondi prej 56 000 000 (pesëdhjetë e gjashtë milionë) lekësh;

b) Në programin buxhetor “Menaxhimi i shpenzimeve publike”, në artikullin 600, pakësohet fondi prej 24 000 000 (njëzet e katër milionë) lekësh;

c) Në programin buxhetor “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”, në artikullin 604, pakësohet fondi prej 32 000 000 (tridhjetë e dy milionë) lekësh.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku